



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401406/3

Tiranë ___/___/2014

Lënda : *Rekomandime për inspektimin e bërë në Organin Administrativ Shtetëror të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë*

Drejtuar : **Drejtorit të Policisë së Qarkut
Z. Ardian ÇIPA**

Tiranë

I nderuar Zoti Çipa,

Avokati i Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku parashikohet se:

"Avokati i Popullit apo personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, (të paraburgosurit), në reparte apo institucione shtetërore, spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise.

Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Avokatin e Popullit nuk duhet të pengohet ose të kontrollohet", në datën 02.10.2014 nga ora 09.30 - 11.00 inspektori Organit Administrativ Shtetëror (OASH) të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë.

Grupi i inspektimit përbëhej nga Nd/komisionerët e Seksionit të Veçantë Sotiraq Nushi dhe Hajredin Hysa.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të të drejtave të qytetarëve që paraqiten në Organin Administrativ Shtetëror (OASH), i cili shqyrton kundërvajtjet administrative në fushën e qarkullimit rrugor; monitorimin e veprimtarisë së këtij organi, si dhe sjelljes së punonjësve të policisë gjatë komunikimit me qytetarët.

Grupi i inspektimit mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës nga Kryetari i Organit Administrativ Shtetëror pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë Zoti Preng Kushta, anëtarët e këtij organi dhe nga disa qytetarë që ishin paraqitur për

shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës.

Ambienti i veprimtarisë së Organit Administrativ Shtetëror:

Organit Administrativ Shtetëror i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë është vendosur pranë Komisarariatit të Policisë Rrugore Tiranë. Ambienti (zyra) ku ky organ zhvillon aktivitetin e tij është shumë i vogël me përmasa rreth 2.5x3m. Ndërkohë u konstatua se nuk ka ambient për qëndrimin dhe akomodimin e qytetarëve kundërvajtës të cilët prisnin radhën për t'u gjykuar, duke qëndruar në këmbë. Theksojmë se numri i tyre në momentin e inspektimit ishte i konsiderueshëm rreth 30 persona. Nga informacionet e mara nga burime të ndryshme, si nga radhët e policisë ashtu edhe nga qytetarët rezultoi se, koha ditore e punës e punonjësve të këtij organi ishte mbi 8 orë. Ajo fillonte në orën 08.00 dhe në mjaft raste mbaronte në orën 20.00. Ndodhur në këto kushte ne vlerësojmë se ambienti ku është vendosur e funksionon ky organ nuk siguron kushte normale pune dhe komoditet, si për punonjësit e policisë ashtu edhe për qytetarët.

Veprimtaria e Organit Administrativ Shtetëror:

Ky organ është ngarkuar nga ligji (Kodi Rrugor) me detyrën e shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor. Në kohën e inspektimit organi funksiononte i plotë me tre punonjës policie, kryetari dhe dy anëtar. Procedimi administrativ kryhej konform dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe Kodi Rrugor, duke respektuar të drejtat e palës kundërvajtëse për t'u dëgjuar rreth pretendimeve ndaj shkeljes së konstatuar nga punonjësit e policisë dhe për të paraqitur provat e mundshme për rastet që kishin kundërshtime. Gjithashtu respektohej edhe e drejta ligjore e palës kundërvajtëse për t'u përfaqësuar me avokat gjatë procedimit administrativ, nëse e kërkonin atë.

Vendimin OASH-ja e merrte në vend pasi konsultoheshin midis tyre dhe një kopje e tij i jepej palës kundërvajtëse.

Në vendim pasqyrohej edhe e drejta ligjore e qytetarit e parashikuar në nenin 202 të Kodit Rrugor për t'u ankuar në gjykatë brenda 5 ditëve ndaj vendimit të dënimit nga OASH-ja. Lidhur me këtë të drejtë konstatuam se ajo, ndonëse është pjesë përbërëse e vendimit të organit të procedimit administrativ, nuk pasqyrohej në pjesën e dispozitivit por në fund të tij, poshtë emrave dhe nënshkrimeve të pjestarëve të OASH-së.

Shumica e kundërvajtësve që gjykoreshin për mosrespektim të sinjalizimit rrugor, semaforit, pretendonin se nuk e kishin kryer shkeljen ligjore të vazhdimin të lëvizjes në kryqëzim kur sinjali i semaforit (drita e kuqe) e ndalonte atë. Për këtë arsye ata kërkonin prova shtesë, si fotografi apo filmime nga kamerat, por për shkak të mungesës së sistemit të monitorimit ato nuk disponoheshin nga organi i policisë.

Organi që shqyrtonte kundërvajtjet administrative gjykonte mesatarisht rreth 44 çështje në një ditë pune. Theksojmë se në ditë të veçanta, numri i çështjeve të shqyrtuara prej tij dhe i detyruar edhe për shkak të respektimit të afatit ligjor, shkonte deri në 80 raste. Sipas gjykimit tonë, kjo shifër është e konsiderueshme dhe tregues i ngarkesës së lartë në punë të këtij organi, që mund të sjellë si pasojë uljen e performancës së vendimarrjes së tij.

Sjellja e punonjësve të policisë gjatë komunikimit me qytetarët:

Gjatë kohës së inspektimit të kryer në këtë organ u monitorua edhe sjellja e punonjësve të policisë gjatë komunikimit me qytetarët e ndryshëm, të cilët kishin ardhur për probleme të ndryshme, si për t'u gjykuar nga Organi Administrativ Shtetëror për shkeljet e dispozitave të Kodit Rrugor, për të marë informacione të ndryshme, për

ankesa, kërkesë, sqarime, etj. Nga monitorimi u konstatua se punonjësit e policisë komunikonin në mënyrë korrekte dhe me etikë me qytetarët e pranishëm. Kjo mënyrë sjelljeje rrit imazhin dhe prestigjin e Policisë së Shtetit në publik dhe ndërkohë edhe besimin e qytetarëve ndaj këtij organi të administratës publike.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e një ambienti të përshtatshëm, me hapësirë e duhur dhe të pajisur me orënditë e nevojshme me qëllim për të siguruar kushte normale pune për veprimtarinë e Organit Administrativ Shtetëror të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë dhe për akomodimin e qytetarëve me qëllim që ata të mosqëndrojnë në këmbë.

2. Analizimin dhe vlerësimin e ngarkesës së punës të Organit Administrativ Shtetëror ekzistues, marrjen në konsideratë të mundësisë së ngritjes të një organi tjetër me qëllim uljen e ngarkesës dhe rritjen e performancës të punës së tij.

3. Ndryshimin e modelit të vendimit të Organit Administrativ Shtetëror, dhe e drejta ligjore e qytetarit kundërvajtës për t’u ankuar në Gjykatën Administrative të vendoset në pjesën e dispozitivit të tij dhe jo në fund të formatit poshtë emrave dhe nënshkrimeve të pjestarëve të këtij organi.

4. Rritjen e bashkëpunimit me subjektet përkatëse të administratës publike për të mundësuar instalimin e sistemit të monitorimit në kryqëzimet e rrugëve për të bërë të mundur vërtetimin e shkeljeve të Kodit Rrugor nga drejtuesit e mjeteve, jo vetëm me procesverbalet e konstatimit të mbajtura nga punonjësit e policisë, por edhe me fotografi dhe filmime. Ne gjykojmë se vendosja e sistemit monitorues do të ndikoj dukshëm edhe në uljen e numrit të shkeljeve ligjore në fushën e qarkullimit rrugor, si dhe në lehtësimin e punës së punonjësve të policisë rrugore.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditorë, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI